



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2257/4 prot.

Datë 25.10.2022

V E N D I M

Nr. 1039/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.10.2022 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Llazo” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-40338-08-31-2022, me objekt “Mbrojtje nga gërryerjet e lumit Osum në zonën e Dafinave, Bashkia Dimal” me fond limit 32,400,079.00 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 16.09.2022, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.
- Ankimues:** BOE “Llazo” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK
Bishqethem 1, Rruga Kemishtaj, Zona kadastrale 1197, nr. pasurie 3/21, Lushnje
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Dimal
Rruga “Dimal” Lagjja “18 Tetori”
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. BOE ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. BOE ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. BOE ankimues nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.09.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-40338-08-31-2022, me objekt “Mbrojtje nga gërryerjet e lumit Osum në zonën e Dafinave, Bashkia Dimal” me fond limit 32,400,079.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 16.09.2022, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.

II.2. Në datën 16.09.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 04.10.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

- BOE “Llazo” SHPK & “Viante” SHPK	28,248,639 lekë	skualifikuar
- “Armir” SHPK	30,142,126 lekë	kualifikuar
- “2Z Konstruktion” SHPK	32,377,412 lekë	skualifikuar
- “ASI-2A Co” SHPK	32,387,114 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 14.10.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2610/2022 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2257 e operatorit ekonomik BOE “Llazo” SHPK & “Viante” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “Llazo” SHPK & “Viante” SHPK.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2257/2 prot., datë 17.10.2022, janë publikuar arsyet e skualifikimit të BOE ankimues.

II.6. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) rezulton, se nuk është kryer publikimi i njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik.

II.7. Me shkresën nr. 2435/19 prot, datë 21.10.2022 protokolluar me tonën me nr. 2257/3 prot., datë 24.10.2022, autoriteti kontraktor ka dërguar në Komisionin e Prokurimit Publik informacion lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga BOE “Llazo” SHPK & “Viante” SHPK.

II.8. Nga informacioni i mësipërm rezulton se autoriteti kontraktor e ka refuzuar ankesën e BOE ankimues me pretendimin se: *“Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë. 7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. 8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyriare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”. 6*

Referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.16272020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 16272020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.” Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit apo njoftimit të anulimit dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk ka filluar ende, për sa kohë autoriteti kontraktor nuk ka publikuar njoftimin e fituesit apo njoftimin e anulimit në sistemin e prokurimeve elektronike për procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Në këtë kuptim, ankesa e

mësipërme shpallur në Komisionin e Prokurimit Publik në datat 17.10.2022 konsiderohen të paraqitura përpara afatit ligjor të ankimimit, duke mos u legjitimuar racione temporis.

Në referim të vendimit nr. 401/2022 të Komisionit të Prokurimit Publik NR. 739/4 prot. datë 29/04/2022 i cili ka shqyrtuar një rast të ngjashëm dhe ka vendosur të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik. Për rrjedhojë ankesa e operatorit ekonomik BOE “Llazo” SHPK & “Viante” SHPK konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimimit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës autoriteti kontraktor vendos refuzimin e ankesës së paraqitur nga BOE “Llazo” SHPK & “Viante” SHPK, Adresa Bishqethem 1, Rruga Kemishtaj, Zona kadastrale 1197, nr. pasurie 3/21, Lushnje.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Në datën 01.09.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-40338-08-31-2022, me objekt “Mbrojtje nga gërryerjet e lumit Osum në zonën e Dafinave, Bashkia Dimal” me fond limit 32,400,079.00 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 16.09.2022, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.

III.2. Në datën 16.09.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

III.3. Në datën 04.10.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

- BOE “Llazo” SHPK & “Viante” SHPK	28 248 639 lekë	skualifikuar
- “Armdmir” SHPK	30 142 126 lekë	kualifikuar
- “2Z Konstruksion” SHPK	32 377 412 lekë	skualifikuar
- “ASI-2A Co” SHPK	32 387 114 lekë	skualifikuar

III.4. Në datën 14.10.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2610/2022 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2257 e operatorit ekonomik BOE “Llazo” SHPK & “Viante” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “Llazo” SHPK & “Viante” SHPK.

III.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna

të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2257/2 prot., datë 17.10.2022, janë publikuar arsyet e skualifikimit të BOE ankimes.

III.6. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) rezulton, se nuk është kryer publikimi i njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik.

III.7. Me shkresën nr. 2435/19 prot, datë 21.10.2022 protokolluar me tonën me nr. 2257/3 prot., datë 24.10.2022, autoriteti kontraktor ka dërguar në Komisionin e Prokurimit Publik informacion lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga BOE “Lazo” SHPK & “Viante” SHPK.

III.8. Nga informacioni i mësipërm rezulton, se autoriteti kontraktor e ka refuzuar ankesën e BOE ankimes me pretendimin se: “Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë. 7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. 8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”. 6

Referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.16272020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 16272020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.” Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit apo njoftimit të anulimit dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk ka filluar ende, për sa kohë autoriteti kontraktor nuk ka publikuar njoftimin e fituesit apo njoftimin e anulimit në sistemin e prokurimeve elektronike për procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Në këtë kuptim, ankesa e mësipërme shpallur në Komisionin e Prokurimit Publik në datat 17.10.2022 konsiderohen të paraqitura përpara afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar racione temporis.

Në referim të vendimit nr. 401/2022 të Komisionit të Prokurimit Publik NR. 739/4 prot. datë 29/04/2022 i cili ka shqyrtuar një rast të ngjashëm dhe ka vendosur të mos pranojë ankesën e

operatorit ekonomik. Për rrjedhojë ankesa e operatorit ekonomik Boe “Llazo” SHPK & “Viante” SHPK konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës autoriteti kontraktor vendos refuzimin e ankesës së paraqitur nga BOE “Llazo” SHPK & “Viante” SHPK, Adresa Bishqethem 1, Rruga Kemishtaj, Zona kadastrale 1197, nr. pasurie 3/21, Lushnje.”

III.9. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.

III.9.1. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.9.2. Neni 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.9.3. Neni 111, pika 1, i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.9.4. Neni 112, pikat 1 dhe 2 i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”

III.9.5. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për kundërshtimin e vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin/klasifikimin përfundimtar, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret BOE ankimues “Llazo” SHPK & “Viante” SHPK, ka dorëzuar ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor me datë 14.10.2022. Ndërkohë nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se nuk është kryer akoma publikimi i njoftimit të fituesit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se BOE ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimin/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”, pasi në datë 14.10.2022 (data që BOE ankimues ka paraqitur ankesë njëkohësisht në KPP dhe autoritet kontraktor) nuk ishte publikuar njoftimi i fituesit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kundër vendimeve të autoritetit kontraktor lidhur me vlerësimin e procedurës së prokurimit, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit ose publikimit të njoftimit të anulimit dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, në datë 14.10.2022 afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk kishte filluar, për sa kohë nuk ishte publikuar njoftimi i fituesit të procedurës së prokurimit, që do të thotë se BOE ankimues nuk i kishte lindur akoma e drejta e ankimit.

Për sa më sipër, ankesa e depozituar njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik dhe autoritet kontraktor në 14.10.2022, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dy institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

III.9.6. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga BOE ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e BOE ankimes “Llazo” SHPK & “Viante” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-40338-08-31-2022, me objekt “Mbrotjtje nga gërryerjet e lumit Osum në zonën e Dafinave, Bashkia Dimal” me fond limit 32,400,079.00 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 16.09.2022, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga BOE ankimes “Llazo” SHPK & “Viante” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Florent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

